

PKR.nr.26/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit, anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtaret Afërdita Bytyçi dhe Beqir Kalludra, me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit F. Xh. për shkak të veprës penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.677-3/2012, të dt: 30.11.2012 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik me dt: **18.11.2015**, të njëjtën ditë bjenë në prezencë të akuzuarit F. Xh. me mbrojtësve av.Q. M. dhe av.A. A. të angazhuar sipas autorizimit, publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

F. XH., nga i ati Xh., e ëma Xh., e vajzërisë H., i lindur me dt. *data e lindjes...*në G., me vendbanim në P., lagjja "...", nr... M., nr..., ka të kryer fakultetin e Ekonomisë, ndërsa absolvent në fakultetin e makinerisë, menaxher i kontraktimeve në kompaninë "...” në P., i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal:*numri personal...*

LIROHET NGA AKUZA

SE: I pandehuri F. Xh. person përgjegjës – menaxher i kontraktimeve në kompaninë private "...” SH.P.K. nga F. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë "...” në tenderin numër 2140902111 të datës: 04.03.2009, për “Furnizim me karburant” për Policinë e Kosovës, ku si kriter kryesorë për vlerësim të këtij tenderi ka qenë çmimi më i ulët I ofruar, ka prezentuar ofertën e rreme me 0.00 premium, në bazë së cilës ofertë kjo kompani është shpallur fituese e tenderit dhe me datë 05.04.2009 ka lidhur kontratë me Policinë e Kosovës për furnizim me karburant, mirëpo me rastin e llogaritjes së pagesës së shërbimeve në faktuar të prezantuara e ka kalkuluar çmimin e transportit mbi vlerën e tregut në shumë prej 0.0855 € / cent për litër, dhe në këtë mënyrë, në periudhën prej dt: 07.04.2009 – 20.05.2010 ka realizuar përfitim material kundërligjorë në shumë prej 153.917,41 € në dëm të buxhetit të Policisë së Kosovës,-

-me çka kishte për të kryer veprën penale: Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 364 par.1 nën.par.1.3 të KPPK-së,

Ndaj të akuzuarit **F. Xh.**

Për veprën penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së merr **AKTGJYKIM LIRUES**, sepse nuk është provuar se i akuzuari F. Xh. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, Policia e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale, mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ngritë aktakuzë PP.nr.677-3/2012 të dt: 30.11.2012 kundër të akuzuarit F. Xh., për shkak të veprës penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së .

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë pas leximit të aktakuzës , me rastin e deklarimit të të akuzuarit lidhur me qështjen e fajsisë në kuptim të nenit 326 par.1 të KPPRK-së, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajsinë, dhe duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajsinë për aktakuzën në fjalë, gjykata duke u bazuar në nenin 327 par.1 nënpar.1.2 të KPPRK –së, ka vendosë që seance e shqyrtimit gjyqësorë të vazhdoj me prezentimin e provave .

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, përfaqësuesi i aktakuzës F. T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë është vërtetuar dispozitivi i aktakuzës se ngritur kundër të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet. Në bazë të provave materjale që janë administruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore vlerësoj se i njëjti është përgjegjës penalisht për shkak të veprës së kryer penale. I propozon gjykates që për veprën penale të mashtrimit në detyrë nga neni 341 par.1 të KPK-së, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe gjykoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Q. M. dhe A. A. fjalën përfundimtare e dorëzojnë në form të shkruar dhe avokati kryesor në pikat e shkurtav të njëjtën e elaboronë duke theksuar sipas seancave gjyqësore dhe ekspertizës së ekspertit financiar, me plotësimin e ekspertizës të dt. 0.01.2015 si dhe në bazë të degjimit të deshmatarëve, K. B. dhe B. S., është arritur të argumentohen të gjitha faktet relevante të kësaj qështje penale që kanë të bëjnë me klientin tonë e e cila në tërsi e përjashton përgjesinë penale të akuzuarit. Konstatimi I dispozitivit të aktakuzës nuk ka asnjë mbështetje në shkresat e lëndës, e sidomos në ekspertizën e plotësuar nga ana e ekspertit financiar Xh. K.. Duke shtuar se F. Xh., përkasisht kompanija H. P. ka aplikuar në tenderin e Policisë së Kosovës për funizim me derivate të naftës, me një dokumentacion krejtësisht të rregullt dhe ligjorë edhe të kompletuar e jo i rrejshëm siq cekët në dispozitivin e aktakuzës, në kauadër të dokumentacionit ofërtues, i akuzuari ka prezentuar përvëq tjerash edhe

kontratën për transport të dt. 10.03.2009 e lidhur mes kompanisë M.-I. nga Sh. dhe H. P., në të cilën kontratë detajisht është përshkruar lartësija e çmimit të transportit të derivative të naftës. Mirëpo fillimisht kur eksperti është ngarkuar me shkresat e lëndës nuk e ka pas në disponim atë kontratë, prandaj edhe rezultati i gjendjes së ekspertizës të parë financiare në të cilën edhe tani thuret prokurorija është pikërisht munges e asaj kontrate, që ka qenë relevante. Mbrojtja konsideron se i akuzuari F. Xh. me asnjë veprim që është përshkruar në aktakuzë nuk ka vë në lajthim as policinë e Kosovës, e as ndonji organ tjetër dhe për këtë arsye në mungësë të provave i propozojnë gjykatës që i njëjti në kuptim të nenit 364 paragraf 1 pikë 1 dhe 3 të KPPRK-së, të lirohet nga aktakuza.

I akuzuari F. Xh. në tërsi e përkrahe fjalën përfundimtare të mbrojtësëve, duke shtuar se vetën e konsideron të pafajshëm dhe kërkon që gjykata ta e lironë nga përgjesija penale.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë në të cilën u administruan të gjitha provat materjale, të njëjtat i vlerësoi veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, e vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të deklartave të deshmiatërve K. B., Xh. K., B. S., duke bërë leximin e dosjes së tenderit numër 200040902111 me titull "Furnizimi me karburante 'e dt: 4.03.2009, duke lexuar ofertën e kompanisë "... " sh.p.k.F. e dt: 9.03. 2009, me leximin e kontratës për transportim (sherbim) e dt. 10.03.2009 e lidhur në mes të kompanisë "... " BGSkopje –Macedonia dhe H.P. –F. , duke bërë leximin e shkresës –shpjegimit shtesë së dt. 24.03.2009 për shpjegime shtesë nga Xh. V., menaxhere e prokurimit e Policisë adresuar kompanisë "...", me leximin e shkresës -shpjegimit shtesë së dt. 25.03.2009 nga F. Xh. , menaxher në "...", adresuar policisë së Kosovës, duke bërë leximin e kontratës numër 2140902111 – Furnizim me karburante të dt. 05.04.2009 e lidhur në mes të Policisë së Kosovës dhe "..."-F.. Lexohet listat e distribuimit nga Dogana e KOSOVËS të dt. 8.10.2012) lista e DUD-ave për importe të realizuar për policinë e Kosovës, me leximin e DUD-at nga Dogana e Kosovë për importet të realizuara nga kompanija H.-P., në periudhën 7.04.2009 -20.05.2010 për nevojat vetanake institucionet të tjera, me leximin e listës distribuimit nga Dogana e Kosovës të dt.13.11.2011 (sçarim për aplikimin e shpenzimeve të transportit), duke bërë leximin e fatures të paraqitura nga kompania H. P. – policisë së Kosovës numër 67 I dt.27.04.2009, me leximin e faturës të paraqitur nga kompanija H.-P. , Policisë së Kosovës për realizimin e pagesave sipas kontratës për furnizim me karburant , me leximin e ekspertizës financiare e ekspertit financiar gjyqësorë Xh. K. të dt. 29.10.2012., duke bërë leximin e plotësimit të ekspertizës financiare të ekspertit financiar , gjyqësorë Xh. K. të dt.16.10.2014, dhe në fund e ka ndërguar të akuzuarin dhe deklarimin e tij e ka marrë si provë .

I ndigjuar në cilësinë e deshmitarit në shqyrtimin gjyqësorë K. B. ka deklaruar, se nga viti 2009 punon në cilësinë e drejtorit në H. P.. Ka qenë i autorizuar edhe në atë kohë,

por edhe tani për nënshkrimin e kontratave për transportin e derivative të naftës . Me rastin e shpalljes së tenderit nga ana e Policisë së Kosovës për furnizimin me derivative të naftës, si pjesë e tenderit është dasht te jetë edhe një kompani -transportuese për shkak se kompanija në fjalë ka përvojë shumë vjeqare në lëminë e derivative të naftës. Kompanija H. P. është përcaktuar dhe e ka përzgjedhë kompaninë M. I. , nga M., sepse me të njëjten kanë pasur bashkëpunim edhe ma heret . Kja kompani ka garantuar në implementimin e kësaj kontrate. Si kompani e specializuar për transportin e naftës me menyra specifike të furnizimit, transportin e ka bërë me auto-cisterna . Përgjesija e transportit e kontratës në fjalë ka qenë deri në liferimin e fundit për transportimin e derivative, në destinacionin e fundit . Gjatë imlementimin e kontratës nuk kanë pasur ndonji vërejtje në punë , sepse sipas kontratës janë përmbushur të gjitha deturimet ndaj kompanisë . Bashkëpunimi ka vazhduar edhe tani bashkëpunojnë me këtë kompani Transporti është bërë në bazë të kontratës dhe dogana ka aplikuar çmimin e kontraktuar me “M. –I. “, sipas transportit. Deshmitari ka shtuar se ende e furnizojnë policinë e Kosovës me derivate të naftës dhe me rastin e furnizimit të policisë së Kosovës nuk kanë vërejtje në realizimin e kontratës. Ajo kontratë është specifike dhe ka kërkesa specifike, se për shembull kërkohet që të dërgohet 2000 litra derivate në vendin “M. e Z. “, në bjeshk, kosto e transportit është më e lartë, dhe për këtë arsye e kanë pasyr për obligim mi mbajt rezervë dikund 500.000 litra derivate .

Eksperti financiar Xh. K. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se ekspertizen e ka përpiluar në bazë të provave ekzistuese të cilat ju kanë dorëzuar me rastin e marrjes së udhëreses. Me rastin e marrjes së shkresave plotësuese nga ana e gjykatës dhe pas analizimit të tyre, ka rezultuar se ka ndryshime të provave në krahasim me provat të cilat i ka poseduar në disponim, me rastin e hartimit të ekspertizës së parë . Një prej provave qenësore, është qështja e kontratës së transportit me transportuesin ndërkombëtarë, të cilin eksperti nuk e ka pas në posedim në shkresat e lëndës, me rastin e përpilimit të ekspertizës së parë. Me egzaminim veçmas të kësaj shkrese apo prove, ka rezultuar që të ndyshohet, apo të plotësohet mendimi i ekspertizës e cila ka të bëjë me dyshimin e mbivlerësimit të shpenzimeve të transportitit nga ana e kompanisë kontraktuese H. P., sepse provat shtesë kanë deshmuar se çmimi i transportit të kompanisë H. P. nuk është i kalkuluar, nuk është i kryer me mjete transportuese vetanake, por është çmimi i kontraktuar mbi bazën e provës së kontratës. Mbi këtë bazë të kësaj prove rezulton se nuk mundet të ketë mbivlerësim të çmimit të transportitit, sepse është një transport të kushtëzuar , një transport faktik , dhe kompanija H. P. nuk ka mbivlerësuar shpenzimet të transportit, nuk ka përfitim jashtëzakonëshëm dhe pabazuar , sepse koston e transportitit e kanë paguar në bazë të raporteve kontraktore të kompanisë M. I., nga M. . Në dosjen e tenderit në rastin e parë, e as në ekspertizën plotësuese nuk ka hasur në ndonji vërejtje nga ana e shërbimit policor të Kosovës. Sipas nenit 15 respektivisht pika 1.5 rregullohet çështja e shpenzimeve të transportit, që do të thot sipas kësaj dosje , çmimi i transportitit duhet të jetë i pranuar nga ana e shërbimit Doganor të Republikës së Kosovës . Eksperti ka shtuar se duke

bërë analizen e çmimit e kompanive të transportitit si rezultat i ndryshimeve, ka dal se çmimi i transportitit nuk ka qenë element konkurrues në tender dhe si I tillë nuk ka qenë kufizues dhe çmimi i transportitit duhet të jetë i pranuar nga ana e shërbimit Doganor të R.Kosovës . Ekspertiza është përpiluar në bazë të provave të cilat i ka pasur në disponim.Si ekspert konsideron, që nuk ka mbivlerësim të shpenzimeve të transportitit nga ana e kompanisë H. P., sepse kostoja e shpenzimeve të transportitit, është e kontaktuar , e fakturuar dhe e paguar. Me plotësimin e ekspertixës është konstatuar se nuk ka mashtrim në detyrë me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm .

I ndigjuar në cilësinë e deshmitarit B. S. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se si puntor i firmes “M. – P. “, ka theksuar se kja firmë është e specijalizuar vetëm për transportin të derivatëve të naftës,Transporti i deritëve të naftës është bërë në bazë të kërkeses H. P. dhe është dërguar deri në liken sipas kërkeses , kompanija e H. P. e ka bërë pagesen e të gjitha shpenzimeve lidhur me transportin e derivative të naftes, Gjatë implementrimin e kontratës nuk ka pasur asnjë vërëejtje nga ana e kompanisë” H. P.” , sipas kontratës dhe kërkesave lidhur me transportin e derivatëve, dhe të gjitha janë realizuar .

Nga leximi i dosjes së tenderit numër 200040902111 me titull “Funizim me karburante “ të dt.4.03.2009, është vërtetuar se i akuzuari F. Xh. si menaxher I H. P. me dt:04.03.2009 me rastin e konkurimit e tyre në tender për funizimin me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës, ka dorëzuar ofertën duke e kompletuar dokumentacionin përkatës, e duke cekë se operatori ekonomik përmbush kërkesat e përshtatëshmerisë të parapara me nenin 61 të ligjit mbi prokurimin Publik në Kosovë dhe menaxheri në fjalë e pranon mundësinë e sanksionëve penale dhe civile, nese operatori ekonomik në fjalë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë, dorëzon dokumentin apo deklaratë, që përmban informata përmajtësisht të gabueshme, ose mashtruese. Me rastit e dorëzimit të tenderit për furnizim me derivate të naftes për nevojat e Policisë së Kosovës , H. P. deklaron dhe vërteton se e posedojnë depot personale të cilat ndodhin në Magjistralen Prishtinë –Ferizaj , fshati B.. Depoja ka kapacitet prej 4.500.000 litra derivate .

Duke bërë leximin e ofertës e kompanisë ‘H. P. “ sh.p.k. F. të dt. 9.03. 2009 është veretuar se e njejta është e kompletuar nga deklarata nën betimë, listës e çmimeve, certifikatave tatimore nga Atk-ja, vërtetimin gjyqësorë nga gjykata Ekonomike, vërtetimin nga KEK-u, garancionin banker, licencen nga MTI, deshmis e depos – fletëposedimi, mjetet transportuese, kontrata me plats(berza), deshmin mbi qarkullimin mbi 3000.000.00 Euro, deklarata për rezerva, deklarata për kompenzime dhe lista e pikave të furnizimit etj në bazë të cilave shihet se menaxher I kompanisë H. P., i akuzuari F. Xh. me rastin e dorëzimit të tenderit për furnizim me derivate të naftës për nevojat e Policisë së Kosovës ka deklaruar dhe vërtetuar se i posedojnë depot personale të cilat ndodhen në Magjistralen Prishtinë –Ferizaj, fshati B. dhe kjo po verifikohet me dorëzimin e fletës poseduese si dhe kopjes së planit të parcelës, në të

cilën është ndertuar depo nga 1 rezervar mbitokësorë dhe 4 rezervarë nëntokësorë me kapacitetin të përgjithshëm prej 4500.000 litra, duke ja bashkangjitur edhe licencën për deponim e cila është vërtetuar nga organet kompetente.

Me Leximin e kontratës për transportimin të dt: 10.03.2009 e lidhur në mes të kompanisë “M. I. “ –M. dhe H. P. – F. shihet se oferta njëkosisht është edhe marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve të kamionëve transportues të Kompanisë “M. I. “ , që të shërbejnë në dobi të H. P. , në F., në mënyrë që të plotësohen nevojat e duhura të furnizimit, çmimi për shërbimet e transportit të derivative të vajit deri në destinacionin përfundimtar , në tërë Kosovën , deri në stacionet kryesore të furnizimit, është 0.0855 Euro, për litër . Ndërsa kompanija “M. I. “ detyrohet që në emër të H. P. ti ofroj shërbimet e transportit për Rafinerinë O. A. Shkup .

Me leximin e shkresë së dt. 24.03. 2009 për shpjegime shtesë nga Xh. V. – mernaxhere e prokurimit e Policisë së Kosovës e adresuar kompanisë H. P. shihet se Xh. V., si drejtor e drejtorisë së Prokurimit të Policisë së Kosovës ka kërkuar shpjegime shtesë lidhur me ofertën e dt. 19.03.2009 në tenderin “Furnizim me Karburante “ - Ritender me nr. të ref 2140902111, sepse duke marrë parasysh se premia e kërkuar për litër është e dhënë nga ana e kompanisë “H. P. “ 0.00 Euro për të gjithë artikujt . Për këtë arsye është kërkuar që të deshmohet se në çfarë mënyrë do ta zbatojnë kontratën poqëse do të perzgjedhet fituese, pasi që e dijmë se distribuimi i naftës nëpër pompa dhe rezervoare kërkon investim dhe shkakton shpenzime, si dhe në qfar mënyrë do të prezentonin obligimet ndaj administratës tatimore , pasqyrat financiare dhe tatimin në fitim, ku kompanija në fjalë merr përgjesinë e plotë për sasinë dhe cilësinë e mallit, gjatë transportimit të derivative . Poashtu detyrohen që të sigurojnë pastrimin cilësor të kamionëve, pas çdo shërbimi që e bëjnë. H. P. detyrohet për porosinë e furnizimit dhe transportimin në “M. I. “ së paku 24 orë përpara. Detyrohet H.-P. që të kryej pagesën për shërbimet e lartëxcekuar në afat prej 30 ditëve, pas pranimit të faturës për transportim të shërbimit .

Duke bërë leximin e shpjegimit shtesë në lidhje me tenderin për furnizim me karburante - Ritender -2140902111 vërtetohet, se me dt. 25.03.2009 F. Xh. duke dhënë përgjigjen me shkrim, ka theksuar se kompanija H. P. është kompani ma e respektuar që në furnizimin e veta e ka Policija e Kosovës e cila është një privilegj, një qarkullim i konsiderueshëm për ne si dhe një marketing i vlefshëm për kompaninë . Kompanija në fjalë ka qarkullim me të madhë të naftës nga rafinerija e rajonit ku si e tillë çdo muaj merr zbritje të konsiderueshme (Rabat). Planifikimi afat mesëm i kompanisë “H. P. “ është shtrirja në shtatë qendrat kryesore të Kosovës .

Me leximin e kontratës numër 2140902111 – Furnizim me karburantë të dt.05.04.2009 , e lidhur në mes të Policisë së Kosovës dhe “H. P. “-F. shihet dhe vërtetohet se kontrata hynë në fuqi më dt 6.04.2011 dhe përmbyllet për një periudhë prej 36 muajsh, me dt. 5.04.2014 . çmimi i tenderit përbëhet nga : çmimi platts dhe premiumit .

Premiumet do të mbeten konstante gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontartës dhe vetëm ndryshimi I çmimit platts do të merret parasysht për përshtaje të çmimit .

Duke bërë leximin listes e distribuimit nga Dogana e Kosovës të dt. 8.10.2012 (lista e DUD-ave për importet të realizuara për Policinë e Kosovës , shihet se dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkeses nga Policija e Kosovës i ka siguruar të dhënët e kërkuara sipas kërkesës për secilin zyrtar doganor i cili ka pranuar , plotësuar DUD-at në rastet e importeve të realizuar nga H. P. , ku shfrytëzuesi është Policija e Kosovës .

Me leximin e DUD-at nga Dogana e Kosovës për importet të realizuar nga kompanija "...", në periudhën nga dt. 7.04.2009 -20.05.2010 për nevojat vetanake dhe institucionet të tjera, shihet se drejtori K. B. e ka autorizuar firmen "...", nga M. që mundet për H. P. nga F. në emër të tij të kryej ndermjetësimin doganor(doganimin dhe zhdoganimin e mallit në export dhe import) në të gjitha deget doganore ne teritorin e Kosovës. Ndersa shpediteri "... nga M. do të realizoj sipas kushteve të përgjithësme të afarizmit të shpeditereve ndërkombtarë, kurse dhënësi i autorizimit do të kujdeset për rregullimin e dokumentacioneve dhe mallit, i cili doganot ose zhdoganimit .

Me leximin listes distributive nga Dogana e Kosovës të dt. 13.11.2011. (sqarim për aplikimin e shpenzimeve) konstatohet se shpenzimet janë të gjitha shpenzimet që lindin me rastin e dërgimit të mallrave komerciale dhe ju referohen shpenzimeve deri tek kufiri I territorit doganor të Kosovës. Këto hynë në kuadër të vlerës së transaksionit që paraqet vlerën doganore të mallrave të importuara dhe të njejtat duhet të jenë në përputhje me rregullat ndërkombëtare. Importuesi "... " sh.p.k. në rastet e importeve për policinë e Kosovës vet ka deklaruar shpenzimet e transportitit 0.0855 euro për litër dhe me paratet CIF , pra të njejtat nuk janë caktuar nga Dogana .

Me Leximin e udhëzimit të brendëshëm i cili i percakton procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informative, afatet e publikimit të dosjes me të dhena të disponueshme dhe shpenzimet e transportitit, vertetohet se sipas nenit 35 pikës 1 të kodit doganor të akcizave ne Kosovë nr. 03/L-109 TË DT. 11 .11.2008 janë cekë përkufizimet dhe referimet ku çdo perkufizim ose, rregull për interpretim që gjendet ne Kodin Doganor dhe te akcizave në Kosovë kodi nr.03/L109,vlen edhe për këtë udhëzim, ku nën pikën 2 janë përcaktuar procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore . Në pikën 3 burimet e informacionit ku si burim të informacionit për krijimin e rubrikes "Të dhënat e disponueshme " sherbejnë qmimet e tregjeve nderkombtare të marra nga agjencia reuters, fatura të konfirmuar nga departamenti i zbatimit të ligjit . Ne pikën 4 janë përcaktuar afatet e përdorimit dhe publikimit të çmimeve, ndersa ne pikën 5 janë shenuar shpenzimet e transportitit ,dhe shpenzimet e dergimit janë të gjitha shpenzimet që lindin jasht teritorit doganor të Republikës së Kosoves , gjatë dergimit të mallrave komerciale sipas kushteve të përcaktuar pas blerjes së atij malli . Ky udhëzim se bashku me ankesat percjellese, hynë në fuqi me datë 1 maj të vitit 2009 .

Me leximin e fatures të paraqitura nga kompanija H. P. - Policija e Kosovës për realizimin e pagesave sipas kontratës për furnizim me karburantet, vërtetohet se secila faturë tatimore e precizon sasinë me litra, përshkrimin e karburantit, çmimin në euro dhe total duke u nisë nga data 30.04.2009 e deri me datën 30.04.2011.

Me leximin e ekspertizës financiare e ekspertit Xh. K., të dt. 29.10.2012 dhe mendimit dhe konstatimit shihet se furnizimi më derivatet të naftës nga ndërmatja private H. P. nga F., Policinë e Kosovës është bazuar në kontratën nr. 2140902111 në mes Policisë të Kosovës dhe H. P. – F. e cila është nënshkruar me dt 19.03.2009 dhe përmbajtja e kontratës është realizuar në pajtim me ligjin e Prokurimit Publik nr. 02/L-99 dhe Rregulloren e Prokurimit Publik nr. 2007/20 Konform LPP-së. Në të gjitha importet H. P. –F., për furnizim më karborante Policinë e Kosovës është pranuar nga dogana çmimi i transportit dhe se i njëjti çmim është inkorporuar si komponent në çmimin total për njësi –litër nga e H. P. –F. e që është fakturuar Policisë së Kosovës. Çmimi i transportit sipas dispozitave të dosjes së tenderit dhe të kontratës nuk ka qenë i limituar si vlerë, por i kushtëzuar që të jetë nga Dogana. Çmimi i transportit pranuar nga Dogana e Kosovës për kompaninë përfituese H. P., për nevoja vetanake, sipas datave referente është në shumë prej 500.00 euro. Vlera e tregut e shpenzimeve të transportit bazuar në informata e siguruar nga palet e tretë për një transport me maunë për periudhën 2009 - 2010, ka qenë në shumë prej 500.00 euro. Kostoja e shpenzimeve të transportit të pranuar nga Dogana e Kosovës, sipas raportit të doganës lidhur me transportet e kompanisë përfituese”... “bazuar në kontratën nr. 2140902111, në mes të Policisë të Kosovës dhe H. P. – F., është në shumë prej 227.544.20 euro. Vlera e shpenzimeve të transportit bruto të kompanisë përfituese “...“ të mbi vlerësuar në krahasim me vlerën e tregut është në shumë prej 178.544,20 euro. Vlera e shpenzimit të transportit neto të kompanisë H. P. të mbivlerësuar në krahasim me vlerën e tregut në shumë prej 153.917.41 euro.

Me leximin e plotësimit të ekspertizës të ekspertit financiar gjyqësorë Xh. K. të dt. 16.10.2014, është vërtetuar se kompanija “... “ – F. ka dorëzuar në afat të paraparë ligjor dosjen e tenderit “Furnizim me Karborante të Policisë së Kosovës me referencën e prokurimit nr. 2140902111. Kjo ndërmarja private është shpall përfituese e tenderit me çmim prej 0.00 të premiumit për furnizim më karborante Policinë e Kosovës. Kontrata me numër të lartëshenuar është nënshkruar me dt. 19.03.2009 dhe është kontratë për 24 muaj. Çmimi i transportit prej 0.0855 euro, për litër është i bazuar në kontratën për shërbime të transportit dhe në raportet kontraktuale në mes të kompanisë H. P. –F. dhe kompanisë M. i. BG-S., M. të dt. 10.03.2009. Eksperti në fjalë ka konstatuar se bazuar në raportet kontraktuale të materializuara sipas kontratës të dt:10.03.23009, për shërbime të transportit në mes të kompanisë H. P. – F. dhe kompanisë “M. I. “ B. S. M., rezulton se nuk ka mashtime në detyrë, më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, apo dobisë pasurore nga ane e kompanisë H. P. me rastin e aplikimit të çmimit të transportit prej 0.0855 euro për litër, konform kontratës nr. 2140902111 në mes të Policisë të Kosovës dhe H. P.it, të nënshkruar me dt.

19.03.2009 . Nuk ka as mbivlerësim të shpenzimeve të transportit nga ana e kompanisë “H. P. – F. . Me këtë plotësim të ekspertizës janë eliminura të gjitha dilemat dhe paqartësitë, por poashtu edhe konstatimi i fundit i dhënë në ekspertizën financiare e cilë është punuar në bazë të dokumentacionit me të cilën ka disponuar eksperti në fjalë, në kohën kur edhe e ka punuar ekspertizën .

I akuzuari F. Xh. në shqyrtimin gjyqësorë nuk e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet dhe në mbrojtjen e vet ka deklaruar se, oferta ka qenë komplet sipas rregullorave të tenderit të shapllur. Oferta ka qenë publike dhe e hapur për autoritetin kontraktues ,dhe në të njëjtën kohë ka qenë të përfshira të gjitha detajet , duke marrë parasysh edhe kontaktin për transport. Përpilimin e kontratës e ka bërë autoriteti kontraktues , faktikisht Policija e Kosovës dhe kontrata ka qenë e përpiluar komplet nga Policija e Kosovës , ku në këtë kontratë roli i kompanisë ka qenë oferta – nënshkrimi i kontratës, si përfqësues i kompanisë. Policija e as Dogana , nuk kanë pasur vërejtje në implementimin e kontratës, dhe faturavë pas shpalljes së fituesit nga Policija e Kosovës.Nuk e dinë oferta e tyre a ka qenë më e ulët në krahasim me çmimet e ofertuesve të tjerë , sepse kompanija e ti nuk ka qasje në oferta tjera . Oferta është publike dhe çdo operator ka pasur mundësinë në afat prej dhejtë ditësh me pas qasje të plotë në ofertën e tyre. Çmimi prej 0.0855 ka qenë pjesë e ofertës e cila është dhënë dhe e pranuar prej Policisë së Kosovës. Për kompaninë “M. I. , “ka deklaruar se është e specializuar për bartjen e naftës duke e përfshirë edhe ruajtjen e cilësisë , dukë bërë transportimin deri në pikën përfundimtare dhe ka ndodh se kja kompani ka bërë shpërndarje edhe në Veriun e Kosovës. Sa i përket furnizimeve nuk e dinë çmimet e sakta, mirëpo a i përket implementimin e kontratës në fjalë, ajo është realizuar në 37 pompa mbarë Kosovës, me një kapacitet të jashtëzakonshëm të punëve në 24 orë në ditë, dhe furnizimi është realizuar në bazë të kontratës që çmimet caktohen në bazë të kontratës - berza, transporti premium, elementet që e caktojnë çmimin. Rafinerija O. nga Sh. dhe M. I., e kanë kryer furnizimin deri në amandamentin e kontratës dhe sipas njohurive të tij nuk kanë lidhë kontratë më me M. i. , pas përfundimit të amandamentit, dhe kontrata është ndërëpre me pajtim të dyanëshëm për shka të kërkesës së Policisë së Kosovës .

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e dëshmitarit K. B., sepse i njëjtën si I autorizuar për nënshkrimin e kontratave për transportin e derivative të naftës, ka vërtetuar se kompanija”... “ është përcaktuar dhe e ka përzgjedhë kompaninë “...“, sepse me të njëjtën ka pasur bashkpunim edhe më heret. Gjatë implementimin e kontratës nuk ka pasur asnjë vërejtje në punë, sepse janë përmbushë të gjitha detyrimet sipas kontratës .

Gjykata e ka aprovuar deklaratën dëshmitarit B. S. , sepse me të njëjtën deklaratë është vërtetuar se kompanija e tyre “...“ si kompani e specializuar për transportin me derivatë të naftës , e ka kryer transportin sipas kërkesave që janë bërë nga kompanija private”.... “, dhe kompanija në fjalë e ka kryer të gjitha pagesat dhe shpenzimet në

lidhje me transportin e derivative , ku gjatë implementimin e kontratës nuk ka pasur asnji vërejtje nga ana e kompanisë.

Gjykata i ka dhënë besimin e plotë deklartës së ekspertit financiar Xh. K. , sepse me atë deklaram ëshët vertetur se provat shtesë kanë deshmuar se qmimi I transportit të kompanisë “... “nuk ëshët I kalkuluar , nuk ëshët I kryer me mjete transportuese vetanake, por ëshët qmimi I kontraktuar mbi bazën e provës së kontratës. Mbi këtë bazë të kësaj prove , rezulton se nuk mundet të ketë mbivlerësim të çmimit të transportitit, sepse ëshët një transport të kushtëzuar , një transport faktik , dhe kompanija H. P. nuk ka mbivlerësuar shpenzimet të transportit, nuk ka përfitim jashtëzakonëshëm dhe pabazuar , sepse koston e transportitit e kanë paguar në bazë të raporteve kontraktore të kompanisë . Me plotësimin e ekspertizës , ëshët konstatuar se nuk ka mashtrim në detyrë nga ana e të akuzuarit, me qëllim të përfitimit të kundërligjëshëm të dobisë pasurore.

Gjykata e ka aprovuar edhe mbrojtjen e avokatëve Q. M. dhe A. A. , me të cilen ëshët vertetur se nuk ka mashtrim në detyrë , nuk ka mundur të vërtetohet teza e akuzës, sepse edhe deshmitarët K. B. dhe B. S. i kanë argumentuar të gjitha fakte relevante të kësaj qëtjeje penale dhe me të njejtat perjashtohet pergjesija penale e F. Xh. , sepse kompanija H.-P. të cilen aj e ka menaxhuar , ka aplikuar në tenderin e Policisë së Kosovës për funizim me derivate të naftës, me një dokumentacion krejtësisht të rregullt dhe ligjorë , edhe të kompletuar.

Mbrojtja e të akuzuarit F. Xh. , gjenë mbështetje edhe tëk provat materjale të argumentuar si më lart, të cilave Gjykata ju dha besimin e plote , sepse me dosjen e tenderit i akuzuari ka garantuar se kompanija H. P. të cilen aj e menaxhon I posedon depot personale me kapacitetin prej 4500,000 litra të derivative dhe të njejtat ndodhin në magjistralin Prishtinë –Ferizaj , tek fshati B. . Kontrata e transportitit të dt. 10.03.2009 e lidhur me M. I. -H. P. ëshët marveshje për shfrytëzimin e shërbimeve të kamionave të transportitit, ku çmimi për shërbimin e transportitit për një litër, ëshët 0.0855 euro. Kompanija H. P. ëshët përcaktuar për kompaninë M. I. duke marr parasyshe se e njejtë ëshët e specializuar për bartjen e naftës dhe për ruajtjen e cilësisë së naftes gjatë transportimit deri në piken referuese . Meqenëse kompanija H. P. ka shtrirje në shatë qëndra kryesore të Kosovës me përgjigjen me shkrim në shkresën e drejtorisë së Prokurimit, I akuzuari ka thekësuar se kompanija H. P. ka qarkullim më të madh të naftes nga rafinerija e rajonit dhe për çdo muaj merr zbritje të konsiderueshme (rabat), ku neprëmesë listave doganore të Kosoves shihet pasqyra e doganimit dhe zhdoganimit të mallit, në export dhe import. Faturat tatimore e precizojnë sasinë në litër, përshkrimin e karburantit , qmimin në euro, dhe në total. Sa i perket shpenzimeve, ato janë të gjitha shpenzime që lindin me rastin e dergimit të mallrave komercijale dhe referohen shpenzimeve, deri te kufiri i teritorit doganor të Kosovës .

Me provat e nxjerura, pa dyshim është vërtetuar se i akuzuari nuk ka bërë mashtrim në detyrë për qellim të përfitimit të kundërligjshëm, apo dobisë pasuroro- juridike. Nuk është vërtetuar se ka kalkuluar çmimin e transportitit. Saktësisht në veprimet e tij nuk ka mbivlerësime të shpenzimeve të transportitit, sepse çmimi i transportitit prej 0.0855 euro për litër, është i bazuar në kontratën për shërbime të transportitit, në mes të kompanisë H. P. – F. dhe kompanisë M. I. B. S. –M.. Shpenzimet e transportit janë fatuar nga kontraktuesit dhe janë paguar nga kontraktuesit.

Meqenëse nuk është provuar se i akuzuari F. Xh. ka kryer veprën penale të përshkruar si në aktakuzë, gjykata konform nenit 364 paragraf 1 nënparagraf 1.3 të KPPRK-së e ka liruar ka aktakuza.

Në bazë të nenit 454 paragraf 1 të KPPRK-së është vendosë që shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore.

Vendimi për udhëzimin e përfaqësuesit të pales së demtuar, për realizimin e kërkeses pasuroro –juridike në kontest civil, është bazuar në nenin 463 paragraf 2 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.26/14, të dt: 18.11.2015

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.